

Lorencat
për marrje në
konsideratë.
Tirani

Nr. 134 Prot.
Dt. 27.04.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1811 prot.

Tiranë, më 24.04.2026

Lënda: Për shpalljen e thirrjes për paraqitjen e shprehjeve të interesit për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të fakulteteve të Drejtësisë dhe Shkollës së Magjistraturës

SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Adresa: Godina "Poli i Drejtësisë", rr. "Ana Komnena"

UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", nr. 3, Tiranë

UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Adresa: Sheshi 2 Prilli 24, Shkodër

UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Adresa: Rruga "Ismail Zyma", Elbasan

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI"

Adresa: Skelë, Rruga Kosova, Vlorë 9401

UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU"

Adresa: Lagjja 14, 2001, Rruga Currila, Durrës

UNIVERSITETIT TË "NEW YORK OF TIRANA"

Adresa: Rruga e Kavajës, pranë 21 Dhjetorit, Tiranë

UNIVERSITETIT "LUARASI"

Adresa: Rruga e Elbasanit, nr. 59, Tiranë

UNIVERSITETIT "ALBANIAN UNIVERSITY"

Adresa: Bulevardi Zogu I, 1001

UNIVERSITETIT "BARLETI"

Adresa: Rruga "Frang Bardhi", Selitë, Tiranë

UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS

Adresa: Rruga "Xhanfize Keko", Kompleksi Xhura, Tiranë

UNIVERSITETIT "EPOKA"

Adresa: Autostrada Tiranë-Rinas, Km. 12

UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta 52", Tiranë

**KOLEGJIT UNIVERSITAR "TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE
(TBU)"**

Adresa: Zona Kadastrale nr. 2529, pranë Rezervave të Shtetit, Lundër, Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR TË BIZNESIT

Adresa: Rruga "Vangjel Noti", nr. 25, Laprakë, Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "QIRIAZI"

Adresa: Rruga "Taulantet", Kodër-Kamëz, Tiranë

Të nderuar,

Në mbështetje të neneve 147 dhe 149 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 36, 37, 39, 134, 135 dhe 137 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, ju bëjmë me dije se me vendimet nr. 2 dhe 3, datë 22.04.2026, kam vendosur shpalljen e dy vendeve vakante për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe shpalljen e një vendi vakant për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e pedagogëve të fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës.

Në zbatim të pikës 2 të neneve 37 dhe 135 jo më vonë se 7 ditë nga shpallja e vendeve vakante, rektori i institucionit të arsimit të lartë dhe drejtori i Shkollës së Magjistraturës shpallin thirrjet për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga anëtarët e personelit akademik dhe nga pedagogët e Shkollës së Magjistraturës që plotësojnë kriteret.

Referuar pikës 5 të neneve 37 dhe 135, mosshpallja e thirrjes në afatin ligjor përbën shkelje disiplinore për rektorin e institucionit të arsimit të lartë dhe drejtorin e Shkollës së Magjistraturës.

Po në zbatim të neneve 40 dhe 138 të këtij ligji, duhet të kryhet nga ana juaj verifikimi i plotë i përmbushjes së kriterëve ligjore nga kandidatët. Mosverifikimi i saktë i këtyre kushteve përbën shkelje disiplinore për anëtarët e dekanatit të fakultetit të Drejtësisë.

Njoftimi i vakancave është publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit:

<https://www.parlament.al/lajme/8d022570-f01d-499d-afbe-f99a49a28f01>

<https://www.parlament.al/lajme/c5895312-5f01-4013-b6bc-ace606e3b329>

Pjesë e njoftimit të publikuar janë edhe dokumentet si më poshtë:

- Vendimet e Sekretarit të Përgjithshëm;
- Formulari i vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- Formulari i vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- Formulari i vetëdeklarimit të konfliktit të interesit;
- Formulari i vetëdeklarimit të kalimit me sukses të procesit të rivlerësimit;
- Formulari i vetëdeklarimit për moskualifikimin e mëparshëm për shkak të verifikimit të pasurisë dhe figurës sipas legjislacionit në fuqi.

Duke vlerësuar rëndësinë e këtij procesi për funksionimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, kërkohet që brenda datës 1 maj të na përcillni shpalljen e thirrjes nga ana juaj, si dhe të angazhoheni në ndjekjen e procedurës me përparësi dhe rigorozitet të plotë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ

